



MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHIMIT TË ZGJEDHJEVE Republika e Shqipërisë – Zgjedhjet Vendore, 21 qershor 2015

DEKLARATË E GJETJEVE DHE PËRFUNDIMEVE PARAPRAKE

Tiranë, 22 qershor 2015 – Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Zyrës së Institucioneve Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut të (OSBE/ODIHR-it) dhe të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresit).

Ambasadorja Audrey Glover është Shefe e Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MVZ-ja) e OSBE/ODIHR-it, e cila filloi punë që në 15 maj. Stewart Dickson është Shefi i delegacionit të Kongresit, përfshirë anëtarë të Komisionit të Bashkimit Evropian të Rajoneve, të cilët filluan punë që në 17 maj.

Vlerësimi bëhet për të përcaktuar nëse zgjedhjet janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës, me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin vendas. Kjo deklaratë e gjetjeve dhe përfundimeve paraprake jepet përpara përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve pjesërisht varet nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor përfshirë përmbledhjen dhe shpalljen e rezultateve, dhe marrjen në shqyrtim të ankesave dhe kërkesëpadive të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. OSBE/ODIHR do të përgatisë një raport të plotë përfundimtar përfshirë rekomandimet për përmirësime të mundshme, përafërsisht tetë javë pas përfundimit të procesit zgjedhor. Raporti i Kongresit do të miratohet në Mbledhjen Plenare në on 20-22 tetor 2015.

PËRFUNDIME PARAPRAKE

Zgjedhësit kishin mundësinë të zgjedhnin midis një spektri të qartë kandidatësh ku përgjithësisht u respektuan liritë themelore të shprehjes dhe tubimit, ndërkohë politizimi i vazhdueshëm i institucioneve shtetërore, dëmtoi administrimin efikas të procesit zgjedhor. Përgjithësisht dita e zgjedhjeve u vlerësua pozitivisht, por u vëzhguan shumë raste të votimit në grup dhe disa parregullsi të rëndësishme procedurale. Numërimi është duke vijuar por fazat fillestare në përgjithësi janë vlerësuar pozitivisht.

Zgjedhjet u zhvilluan në kuadrin e një rishikimi të ri të njëjësive të qeverisjes vendore (NJQV-ve). Këto janë zgjedhjet e para për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshillave të secilës prej 61 bashkive të sapo krijuara. Zgjedhjet shihen si një provë e rëndësishme e ecurisë së reformës për qeverisjen vendore dhe e arritjes së fundit të Shqipërisë për marrjen e statusit kandidat për Bashkimin Evropian.

Kuadri ligjor mund të ofronte bazën për zgjedhje demokratike, megjithatë, mungesa e vullnetit politik nga partitë kryesore politike për ta zbatuar atë efektivisht dhe politizimi i institucioneve të përfshira në procesin zgjedhor vijoi të pengonte procesin zgjedhor. Hapësirat dhe paqartësitë në legjislacion mbi disa pikëpamje të rëndësishme të procesit zgjedhor mund të rregulloheshin më parë. Mungesa e qartësisë ligjore solli zbatim të paqëndrueshëm të legjislacionit, i cili shpesh u perceptua përgjatë linjave partiake.

Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ-ja) funksionoi përgjithësisht në mënyrë të hapur, me seanca publike të ndjekura rregullisht nga vëzhguesit, media dhe përfaqësuesit e partive. Megjithatë, natyra e diskutimeve të politizuara të KQZ-së solli vendime të paqëndrueshme, të cilat dëmtoan besimin e

publikut në pavarësinë e administrimit zgjedhor. Nuk u respektuan disa afate, përfshirë caktimi i komisioneve të niveleve të dyta dhe regjistrimi i kandidatëve. KQZ-ja duhej të siguronte më mirë drejtimin dhe mbikqyrjen e fazave kyçe të procesit zgjedhor. U zhvilluan një sërë programesh mbi edukimin e zgjedhësve përfshirë këtu gratë, minoritetet vendore dhe zgjedhësit për herë të parë.

Në përgjithësi, bashkëbiseduesit shprehën kënaqësi mbi saktësinë e listave të zgjedhësve. Megjithatë, mbeten ende pezull hetimet e kryera nga zyrat e prokurorive në tri bashkitë në lidhje me shtimin e emrave në listat e zgjedhësve duke krijuar shqetësime në lidhje me integritetin e sistemin e regjistrimit të zgjedhësve.

Gjithsej, 63 parti u regjistruan për zgjedhjet, po ashtu rreth 36,341 kandidatë për kryetarë të këshillave bashkiakë dhe 158 për kryetarë bashkie. Shumica e partive u bashkuan me një nga dy koalicionet e kryesuara nga Partia Socialiste apo Partia Demokratike, 11 parti konkurruan vetëm dhe 14 kandidatë garuan të pavarur. Ndërsa kjo i ofroi zgjedhësve një sërë alternativash politike. Zbatimi i paqendrueshëm i rregullave për regjistrimin e kandidatëve, përfshirë dorëzimin e nënshkrimeve mbështetëse dhe mundësinë për t'u tërhequr, pengoi të drejtën për të qenë të barabartë që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standartet e tjera ndërkombëtare.

Të gjitha partitë përmbushën kërkesën e re mbi listat e kandidatëve për të përfshirë 50 përqind të secilës gjini, duke ndryshuar gjininë në çdo emër të dytë. Dhjetë përqind të kandidatëve për kryetar bashkie ishin gra. Vëmendje e madhe iu kushtua zgjedhësve gra, veçanërisht në platformat e fushatës dhe edukimin e zgjedhësve. KQZ-ja përbëhet nga tri gra, një nga të cilat është kryetarja, por gratë ishin të nënperfaqësuara në komisionet e niveleve më të ulëta.

Atmosfera e fushatës ishte paqësor, përveç incidenteve të izoluar. Përgjithësisht, u respektuan liritë themelore të shprehjes dhe të tubimit. Fushata ishte aktive dhe e dukshme në zonat urbane dhe më modeste në ato rurale. Tonet e fushatës u përmirësuan; megjithatë, partitë e mëdha vijuan të përdornin akuza personale dhe përpjekje për të zhvlerësuar konkurrentët e tjerë.

Pati akuza të shumë për presion mbi zgjedhësit që rritën shqetësimin rreth mundësisë së zgjedhësve për të hedhur votën e tyre pa frikën e ndëshkimit, në kundërshtim me përmbushjen e detyrimeve të OSBE-së. Një numër personalitetesh të larta nga partitë e mëdha qeverisëse përdorën aktivitetet dhe burimet shtetërore për qëllimet e fushatës, duke përfshirë shpërndarjen e çertifikatave për legalizimin e pasurisë, e cila mjegulloi ndarjen midis shtetit dhe partisë.

Partitë politike mund të financojnë fushatën e tyre zgjedhore me kontribute të fondeve shtetërore, donacione private apo hua. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë fonde shtetërore. Rregullat mbi deklarimin e financimit të fushatës nuk janë të plota dhe mund të përmirësohen për të siguruar transparencë më të madhe.

Pavarësisht numrit të madh të mjeteve të informacionit, lidhjet e medias me partitë kryesore politike, si rezultati i interesave të biznesit të pronarëve të mediave shkaktoi ndërhyrje të drejtpërdrejtë në censurimin e autonomisë mediatike, dhe kufizoi pluralizmin e këndvështrimeve. Lajmet u mbizotëruan nga filmimet e fushatës të cilat u prodhuan nga vetë partitë politike, duke mjegulluar ndarjen strikte midis përmbajtjes editoriale dhe reklamave politike. Resultatet e monitorimit të medias së MVZ-së së OSBE/ ODIHR-it treguan se të gjithë kanalet televizive të monitoruara, duke përfshirë dhe transmetuesin shtetëror favorizuan një nga partitë më të mëdha në mbulimin e fushatës së tyre. Edhe pse kërkohet nga ligji, KQZ-ja nuk vendosi gjoba kundrejt stacioneve televizive për shkëlqen e dispozitave mbi mbulimin e paanshëm të konkurruesve. Transmetuesi shtetëror iu përmbajt detyrimeve për të ofruar kohë transmetimi falas të paanshëm për konkurruesit.

Mënyra sesi komisionet zgjedhore dhe gjykatat shqyrtuan ankimmimet zgjedhore shpesh i lanë palet e interesuara pa një rregullim efikas, që është në kundërshtim me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, viti 1990. Edhe pse partitë ngritën një sërë akuzash për shkelje të fushatës, u dokumentuan pak ankesa të tilla mbi këto çështje. Bashkëbisedues të ndryshëm të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën mungesë besimi në administrimin e zgjedhjeve dhe gjykatat për të shqyrtuar ankimmimet në mënyrë të paanshme.

Minoritetet në përgjithësi nuk u diskriminuan gjatë procesit zgjedhor. Ndërkohë që fletët e votimit u prodhuan vetëm në gjuhën shqipe, KQZ-ja shpërnda materialet e edukimit të zgjedhësve në gjuhën minoritare. Edhe pse komunitetet Rome dhe Egjiptiane mbeten të cënuara për blerje vote, është një fushatë në lidhje me vlerën e votës në rritje, ashtu si edhe përfshirja e madhe të këtyre çështjeve në fushatë.

Në përgjithësi dita e zgjedhjeve vijoi në mënyrë paqësore në të gjithë vendin. Vëzhguesit partiakë u vunë re në masë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor ndërsa vëzhguesit jopartiakë ishin më pak të pranishëm. Edhe pse procedurat e hapjes së votimit u vlerësuan negativisht në masën 25% të vëzhgimeve, kryesisht për shkak të hapjes me vonesë të qendrave të votimit, votimi u vlerësua pozitivisht në masën 93% të vëzhgimeve. Megjithatë, u vëzhguan shumë raste të votimit në grup, po ashtu dhe votime me përfaqësim, dhe nënshkrime qartësisht të ngjashme në listat e zgjedhëzve. Shqetësime u vunë re rreth kërcënimeve të mundshme nga grupe të aktivistëve partiak brenda dhe jashtë listës së votimit. Fazat fillestare të mbylljes së numërimit u vlerësuan pozitivisht, edhe pse procesi i numërimit është duke vijuar në të gjithë VNV-të e vëzhguara.

GJETJET PARAPRAKE

Të përgjithshme

Zgjedhjet e qeverisjes vendore të 21 qershorit u zhvilluan në këndvështrimin e një rishikimi të ri të njësive të qeverisjes vendore (NJQV-ve).¹ Këto ishin zgjedhjet e para për të zgjedhur kryetarët e bashkive dhe këshillat vendore në 61 bashki të sapo krijuara, që do të zëvendësojnë 373 bashki dhe komuna që ekzistonin më parë. Reforma e qeverisjes vendore është duke vijuar dhe kompetencat e sakta të bashkive të reja do të përcaktohen në periudhën paszgjedhore. Këto zgjedhje ishin gjithashtu të parat e mbajtura që kur Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat i Bashkimit Evropian në qershor 2014. Këshilli Evropian theksoi se prioritetet kyçe kanë nevojë të përmbushen, veçanërisht në reformën “administrative dhe gjyqësore, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe të drejtave themelore”.²

Reforma e NJQV-ve ishte politikisht përçarëse. Edhe pse të gjithë partitë ranë dakord mbi nevojën për të ulur numrin e NJQV-ve, opozita dhe disa parti joparlamentare u ankuan që procesi i reformës nuk ishte gjithëpërfshirës dhe ndarja e re u bë midis linjave partiake dhe jo gjithmonë duke pasur parasysh veçoritë e zonave të populluara nga minoritetet. Si pasojë, parlamenti miratoi NJQV-të e rishikuara pa mbështetjen e Partisë Demokratike (PD), Partisë Republikane (PR), dhe Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ). PD-ja e kundërshtoi reformën në Gjykatën Kushtetuese, e cila rrëzoi ankimmimin në dhjetor 2014. Në janar 2015, Kolegji Zgjedhor i Gjykatës së Apelit të Tiranës (Kolegji Zgjedhor) shfuqizoi vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së) për të mbledhur kërkesa nga grupet qytetare, mbështetur nga opozita, për mbajtjen e 130 referendumeve vendore për të kundërshtuar NJQV-të e rishikuara.

¹ Të gjithë raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR në Shqipëri gjenden në: www.osce.org/odihr/elections/albania;
² Shih Progres Raportin mbi Shqipërinë në Lufta Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe në Reformën në Gjyqësor tek: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/al_report_june_2014.pdf.

Në prag të zgjedhjeve klima politike mbeti e polarizuar midis opozitës PD-së dhe koalicionit qeverisës të Partisë Socialiste (PS-së) dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI-së), edhe pas ndërmjetësimit të Parlamentit Evropian, çka çoi në përfundimin e bojkotit pesë mujor të parlamentit nga PD-ja, në dhjetor të 2014-tës. Sipas marrëveshjes politike e cila i dha fund bojkotit, mazhoranca qeverisëse dhe opozita ranë dakord të bashkëpunojnë për dialog politik dhe të punojnë së bashku në mënyrë konsensuale, duke përfshirë çështjet e personave me precedente penale që mbajnë apo të zgjidhen apo emërohen në detyra shtetërore.

Në zgjedhje garuan 2 koalicione, 11 parti garonin vetëm, si dhe një numër kandidatësh të pavarur. “Aleanca për Shqipërinë Europiane” (ASHE-ja) u krijua nga dy partitë e mëdha qeverisëse, PS-ja dhe LSI-ja si dhe nga 35 parti të tjera. Kjo përfshiu Partinë për Drejtësi Integritet dhe Unitet (PDIU), e cila ka qënë partia e dytë më e madhe opozitare në parlament.³ Aleanca Popullore për Punë dhe Dinjitet (APPD) u krijua nga opozita PD-ja së bashku me PR-në dhe 13 parti të tjera. Në partitë që garonin vetëm bënte pjesë edhe PBDNJ-ja, e cilaka një Zv.Ministër në qeveri, dhe Partia Social Demokrate (PSD) të cilat shpesh kanë qënë pjesë e koalicionit të kryesuar nga PS-ja, duke përfshirë zgjedhjet e fundit parlamentare.

Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor

Gjithsej 61 kryetarë bashkish zgjidhen me konkurim një raundsh dhe 1,595 këshilltarë zgjidhen në bazë të sistemit proporcional me lista të mbyllura, të gjithë për mandate katër vjeçare. Zonat zgjedhore për zgjedhjet vendore janë territoret e bashkive.

Zgjedhjet vendore rregullohen pikësisht nga Kushtetuta, Kodi Zgjedhor dhe nga rregulloret e KQZ-së.⁴ Kodi Zgjedhor u ndryshua gjerësisht në 2012 pas një procesi gjithëpërfshirës të mbështetur nga partitë e mëdha. Ndryshimet trajtuan një numër rekomandimesh të bëra më parë nga OSBE/ODIHR-i dhe Komisioni i Venecias.⁵ Ndryshimet e mëpasshme, në prill 2015 pasqyruan ndarjen e re administrative territoriale dhe trajtuan rekomandimet e qendrueshme të OSBE/ODIHR-it, për të promovuar kandidatet gra duke shtuar kuotat gjinore në listat e kandidatëve për këshillat vendorë deri në 50 përqind, duke ndryshuar gjininë në çdo emër të dytë. PD-ja dhe PR-ja nuk i mbështetën ndryshimet në lidhje me ndarjen administrative territoriale, por miratoi nenet mbi kuotat gjinore.

Disa prej rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias mbeten të paadresuara, përfshirë masat për të rritur paanëshmërinë e komisioneve zgjedhore, transparencën e financimit të fushatës, dhe zgjidhjen efektive të mosmarrëveshjeve zgjedhore. Këto çështje u vërtetuan të jenë problematike përsëri gjatë këtyre zgjedhjeve. Boshllëqet dhe paqartësitë proceduriale në Kodin Zgjedhor përfshijnë përkufizimin e një subjekti zgjedhor, paqartësinë e mbledhjes së nënshkrimeve dhe verifikimin e kërkesave për regjistrimin e kandidatit, mungesa e rregullimeve mbi dorëheqjen e kandidatit, afatet e paqëndrueshme për shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave ankimore dhe pamjaftueshmëria e rregulloreve të fushatës.

Pavarësisht këtyre mangësive, kuadri ligjor mund të kishte siguruar bazën për zgjedhje demokratike; megjithatë, mungesa e vullnetit politik nga partitë më të mëdha politike për ta zbatuar atë efektivisht

³ Një numër partish të vogla të cilat ishin pjesë e koalicionit të kryesuar nga PD-ja në zgjedhjet vendore të 2011 dhe zgjedhjet parlamentare të 2013 vendosën gjithashtu ti bashkoheshin koalicionit ASHE.

⁴ Legjislacioni tjetër përkatës përfshin Ligjin mbi Qeverisjen Vendore, Ligjin mbi Partitë Politike, Ligjin mbi Tubimet dhe nenet e Kodit të Procedurës Administrative dhe Kodin Penal.

⁵ Këto përfshijnë një proces të përzgjedhur të ndryshuar për anëtarët e administratës zgjedhore, duke përfshirë Kryetarin e KQZ-së, një proces të rishikuar për përpilimin e listës së zgjedhësve, një proces të thjeshtuar për regjistrimin e kandidatëve, dhe më shumë akses të barabartë medias dhe financimet publike të fushatës. Shiko Opinionin e Përbashkët të Komisionit të Venecias, 2011 të OSBE/ODIHR-it tek <http://www.osce.org/odihr/86424>

dhe politizimi i institucioneve të përfshira në procesin zgjedhor vazhdoi të rrezikojë procesin zgjedhor. Boshllëqet dhe paqartësitë në legjislacion mbi disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor mund të ishin rregulluar paraprakisht, përfshirë regjistrimin dhe dorëheqjet e kandidatit. Mungesa e qartësisë ligjore, kontriboi në zbatimin e paqëndrueshëm të legjislacionit, i cili shpesh u perceptua të ndiqte linjat partiake.

Administrimi i Zgjedhjeve

Zgjedhjet u administruan nga KQZ-ja, 90 Komisione të Administrimit të Zonave Zgjedhore (KZAZ-të), dhe 5,301 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV-të). Numërimi u zhvillua nga Grupet e Numërimit (GN-të) në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV-të), në 90 Zona të Administrimit Zgjedhor (ZAZ-të). Komisionet Zgjedhore të të gjitha niveleve kanë shtatë anëtarë të emëruar nga mazhoranca dhe opozita parlamentare së bashku me Kryetaren e KQZ-së të emëruar nga parlamenti. KQZ-ja përfshin tri gra, një nga të cilat është kryetarja. Gratë llogariten një e treta e anëtarëve të KZAZ-ve dhe 17% të tyre përfaqësuan anëtarët e KQV-ve, të vëzhguara ditën e zgjedhjeve.

KQZ-ja është organ i përhershëm, përgjegjës për mbarëvajtjen e përgjithshme të zgjedhjeve. Në përgjithësi, KQZ-ja funksionoi në mënyrë të hapur, me seanca publike të ndjekura rregullisht nga vëzhguesit, media dhe përfaqësuesit e partive politike. Hap pozitiv, që KQZ-ja miratoi Rregulla të Procedurës së Brendshme përpara këtyre zgjedhjeve. Megjithatë, u vu re në shumë mbledhje të saj, natyra e politizuar e diskutimeve të KQZ-së, madje edhe mbi çështje të pastra teknike. Qasja e paqëndrueshme e KQZ-së mbi regjistrimin dhe dorëheqjet e kandidatit rezultoi në vendime kontradiktore, duke sjellë ndarje partiake në komision.⁶ Në rastin tjetër, vendimi i KQZ-së mbi miratimin e listës së partive që kanë të drejtën për grupet e numërimit çoi në përjashtimin e një partie të certifikuar nga përfaqësuesit e caktuar në grupet e numërimit.⁷ E gjitha kjo dëmtoi besimin e publikut në pavarësinë dhe efikasitetin e komisioneve zgjedhore.⁸

Komisionet Zgjedhore nuk respektuan disa afate, duke përfshirë miratimin e emërimit të partive për grupet e numërimit, ngritjen e KQV-ve, grupeve të numërimit dhe regjistrimin e kandidatëve. Ndonjëherë, vendimet e KQZ-së jo gjithmonë u publikuan brenda afateve të përcaktuara në faqen e saj zyrtare.⁹ KQZ-ja duhej të siguronte drejtim dhe mbikqyrje më të mirë të fazave kyçe të procesit zgjedhor.

KQZ-ja prodhoi një sërë materialesh mbi edukimin e zgjedhësve, regjistrimin e zgjedhësve, procedurat e votimit, votimin familjar dhe blerjen e votës, ashtu sikundër edhe materiale për të promovuar pjesëmarrjen e gruas, personave me aftësi të kufizuara dhe zgjedhësve për herë të parë.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vizitoi 85 KZAZ para ditës së zgjedhjeve, të cilat punuan me nivele të ndryshme profesionalizmi dhe efikasiteti. Shumica e KZAZ-ve shprehën pakënaqësitë në lidhje me

⁶ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi se KQZ-ja unanimisht përshtati rreth 130 vendime, shumica vendime teknike duke përfshirë zëvendësimet e anëtarëve të KZAZ-ve, regjistrimin e vëzhguesve dhe miratimin e fletëve të votimit. Megjithatë nga 40 vendime mbi çështjet më thelbësore ishin më shumë të adaptuara me ndarjen e votës katër me tre, përfshirë atë mbi krijimin e grupeve të numërimit dhe regjistrimin dhe dorëheqjet e kandidatit.

⁷ Në një përpjekje për të mirëmbajtur ekuilibrin politik në grupet e emërimit, KQZ-ja nuk mundi të zbatoi ligjin. Neni 96 i Kodit Zgjedhor kërkon anëtarët e tretë dhe të katërt të grupeve të numërimit të zgjidhen me short, gjë e cila nuk u krye. Shorti duhej të përfshinte partitë e regjistruara parlamentare të mazhorancës dhe opozitës të cilat fituan të paktën dy vende në zgjedhjet e fundit parlamentare. Si rezultat LSI-ja dhe PR-ja u përfaqësuan në grupet e numërimit, duke lënë jashtë PDIU, e cila duhej të kish qënë e përfaqësuar.

⁸ Sipas Paragrafit 20 të vitit 1996 të Komentit të Përgjithshëm të UNCHR Nr.25 “Një autoritet zgjedhor i pavarur duhet të krijojë të supervizojë procesin zgjedhor dhe të sigurojë se zhvillohet i drejtë, i paanshëm dhe në përputhje me ligjet e krijuara të pajtueshme me Marrëveshjen.

⁹ Neni 24.3 i Kodit Zgjedhor kërkon që vendimet e KQZ-së brenda 24 orëve të zbardhen dhe të publikohen menjëherë në faqen zyrtare të KQZ-së. Qysh nga shpallja e zgjedhjeve, KQZ-ja ka kaluar gati 700 vendimeve.

pengesa vepruese në punën e tyre.¹⁰ Kështu, deri më datë 20 qershor, u zëvendësuan 234 nga 630 anëtarë të KZAZ-ve (37 përqind), kryesisht me kërkesë të partive që i emëruan. Këto zëvendësime vijuan deri ditën e zgjedhjeve duke dëmtuar punën e tyre si dhe pavarësinë e supozuar të administrimit të zgjedhjeve.¹¹ KQZ-ja zhvilloi trajnimet për anëtarët e KZAZ-ve të cilët u vlerësuan nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR me cilësi të ndryshme.

KQV-të duhej të ishin ngritur në 1 qershor dhe grupet e numërimit në datë 11 qershor, por afatet nuk u përmbushën nga shumë KZAZ.¹² Kjo kryesisht për shkak të emërimeve të vona nga partitë, të cilat ishin të shqetësuara rreth rryshfeteve të mundshme të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore nga kundërshtarët e tyre. Sipas gjykimit të partive politike, emërimet e vonuara u përdorën për të shmangur pengesën ligjore mbi zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve. Kjo solli ndikim në trajnimin e anëtarëve të KQV-ve, të cilët në shumë raste të vëzhguara, patën pjesëmarrje të ulët.

Regjistrimi i Zgjedhësve

Sistemi i regjistrimit të zgjedhësve është pasiv. Listat e Zgjedhësve (LZ-të) nxirren nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC-së), që mbahet nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC-ja). Të gjithë shtetasit e moshës 18 vjeç ose më shumë gjatë ditës së zgjedhjeve kanë të drejtë vote, me përjashtim të atyre që janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjykate. Personat që nuk janë shtetas Shqiptarë nuk kanë të drejtë vote në zgjedhjet vendore, pavarësisht kohëzgjatjes së vendbanimit të tyre.¹³ Edhe pse zgjedhësit duhet të kishin qënë njoftuar nga kryetarët e bashkive rreth qendrave të votimit të tyre përkatëse, në një numër zgjedhësish të ZAZ-ve në një numër zgjedhësish ZAZ-ve u ankuan se nuk kishin marrë njoftimet.¹⁴ Sipas ligjit, zgjedhësit e moshës 100 vjeç ose më shumë hiqen nga listat e zgjedhësve, përveç rasteve kur ata konfirmojnë të dhënat e tyre.¹⁵ Diskriminimi i moshës është në kundërshtim me paragrafin 5.9 të vitit 1990, të Dokumentit të Kopenhagenit OSBEs dhe me detyrime të tjera ndërkombëtare.¹⁶ Sipas DPGJC, lista përfundimtare e zgjedhësve përmbante 3,370,206 zgjedhës. Disa bashkëbisedues vunë re se një numër i madh i shtetasve jo banues të zonave të tyre, ishin në listat e zgjedhësve.

Proçesi i përpilimit të listës së zgjedhësve u vlerësua nga dy auditues të caktuar të cilët përgatitën raporte të ndara çdo muaj. Në përgjithësi bashkëbiseduesit shprehën kënaqësi në lidhje me saktësinë e listave të zgjedhësve. Zyrat e Gjendjeve Civile shpallën ekstraktet e listave të votuesve në çdo qendër votimi për publikun. Zgjedhësit mund të verifikonin të dhënat e tyre në faqen e internetit të MB. Disa

¹⁰ Këto pengesa përfshijnë mungesën e pajisjeve, mjetet e transportit, mjedise të papërshtatshme dhe mungesën e fondeve. Shumë KZAZ u ankuan se nuk kanë marrë kontribute pavarësisht fondeve për zgjedhjet që iu akorduan KQZ-së në shkurt dhe disa anëtarë KZAZ-je raportuan se i kanë mbuluar disa nga shpenzimet e tyre.

¹¹ OSBE/ODIHR ka rekomanduar që kjo mundësi të hiqet nga dispozitat. Seksioni II.3.1.77 i raportit shpjegues i vitit 2002 të Kodit mbi Praktikën më të Mirë në Çështjeve Zgjedhore të Komisionit të Venecias, thekson: Organet të cilat emërojnë anëtarët në komisionet zgjedhore nuk duhet të jenë të lirë ti rimarrin pasi kjo ngre dyshimet mbi pavarësinë e tyre. Tërheqja e komisionerëve është e papranueshme...

¹² Në 19 qershor KQZ-ja shprehu shqetësimet se KQV-të dhe grupet e numërimit në 16 ZAZ-të nuk ishin ngritur ende dhe kundërshtuan partitë politike për të emëruar anëtarët e KQV-ve. Në Kurbin, mungesa e emërimeve të anëtarëve të KQV-ve nga PD-ja ditën e zgjedhjeve çoi në hapjen me vonesë të votimit në disa qendra votimi.

¹³ Seksioni I.I.I.b i vitit 2002 Kodi mbi Praktikën më të Mirë në Çështjeve Zgjedhore të Komisionit të Venecias, thekson se: “Këshillohet për të huajt të votojnë për zgjedhjet vendore pas një periudhe të caktuar ta banimit.”

¹⁴ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u njoftua se zgjedhësit nuk kanë marrë njoftimet në ZAZ-të 1-8,12-25, 17-19, 29-41, 85 dhe 86. Në ZAZ-të 22-24 zgjedhësit raportuan marrjen me vonesë të njoftimeve të zgjedhësve.

¹⁵ Që nga 12 maji, nga 1,288 zgjedhës të regjistruar mbi moshën 100 vjeç konfirmojnë të dhënat e tyre.

¹⁶ Sipas paragrafit 5.9 të vitit 1990 Dokumenti i Kopenhagenit i OSBE-së “Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim, të kenë të garantuar mbrojtje të njëjtë para ligjit”. Shiko gjithashtu Nenin 26 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

KZAZ nuk morën dy kopje të printuara dhe versionin e përmbledhjes elektronike të listës përfundimtare të zgjedhjeve deri në afatin e datës 18 Maj.¹⁷

Të burgosurit mund të votojnë në zgjedhjet vendore. Një nga audituesit të caktuar nga KQZ-ja, i cili ishte i emëruar nga PD, identifikoi 197 të burgosur të cilët nuk ishin përfshirë në listën finale të zgjedhësve. Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se rreth 3,000 nga 5,700 të burgosur nuk u përfshinë në listën e zgjedhësve për arsye të gabimeve dhe vonesave në informacionin e paraqitur nga kryetari i burgjeve.¹⁸

Në maj, të njëjtët auditues të KQZ-së, gjithashtu ngritën dyshime për rritje të numrit të zgjedhësve të regjistruar me 2,186 në Durrës dhe me 595 në Kavajë. Në 15 qershor, LSI-ja dorëzoi në prokurorinë e rrethit një rast në lidhje me një rritje prej 500 zgjedhësish në Vorë. Fakti se këto raste mbeten nën hetim nga prokuroria e rrethit sollën disa shqetësime rreth integritetit të sistemit të regjistrimit të zgjedhësve.

Regjistrimi i Kandidatëve

Çdo qytetar me të drejtë vote mund të kandidojë në zgjedhje, përveç atyre që janë duke vuajtur dënim me burgim. Kandidatët mund të propozohen nga partitë politike, koalicionet e partive ose grupe zgjedhësish. Gjithsej, 63 parti u regjistruan për zgjedhjet, dhe 36,41 kandidatë garuan për këshillat bashkiakë, përfshirë 12 kandidatë të pavarur. Të gjitha partitë përbushën kërkesat për kuotat e reja gjinore dhe 49,4 përqind e kandidatëve ishin gra. Nga 158 kandidatë që konkuruan për kryetar bashkie, 14 prej tyre garuan në mënyrë të pavarur dhe 16 prej tyre ishin gra.

Partive politike dhe kandidatëve të përfaqësuar në Parlament apo në qeverisje vendore nuk u kërkohet të dorëzojnë nënshkrimet për të regjistruar kandidatët e tyre. Të gjithë kandidatëve të tjerë u kërkohet të dorëzojnë nënshkrimet mbështetëse për të paktën një përqind të zgjedhësve nga bashkitë e tyre përkatëse.¹⁹ Megjithatë, KQZ-ja në vendimin e saj Nr.88, datë 7 Prill, theksoi që konkurruesit zgjedhorë të përfaqësuar vetëm në komuna, ju kërkohet të mblidhnin nënshkrimet mbështetëse, me arsyetimin se komunat nuk njihen më nga Kodi Zgjedhor, si pasojë e reformës së NJQV-ve. PSD-ja apeloj një vendim të KQZ-së që refuzonte listën e kandidatëve të saj në Durrës me këto argumenta dhe Kolegji Zgjedhor vendosi se subjektet që gëzonin mandate në çdo nivel përjashtohen nga mbledhja e nënshkrimeve.²⁰ Rrjedhimisht KQZ-ja regjistroi listën e PSD-së pa nënshkrimet mbështetëse.

KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor vepruan në mënyrë të paqendrueshme për sa i përket regjistrimit të kandidatëve të tjerë të PSD-së. Dy kandidatura për kryetarë bashkie të PSD-së që mbajnë mandate në komuna, nuk u regjistruan për shkak të mungesës apo vonesës së dorëzimit të certifikatave të mandateve, pavarësisht se kjo nuk ishte e specifikuar në vendimin Nr.88 të KQZ-së për ata të cilët

¹⁷ Nga kopjet e printuara, njëra është e shpallur në qendrën e votimit, ndërsa tjetra është e përdorur nga KQV-të ditën e votimit. Ligji është i paqartë se kujt duhet t'i mundësohet versioni elektronik i listës finale të votimit të KZAZ-ve.

¹⁸ Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rreth 2,265 të burgosur morën vendim gjyqate për t'i lejuar të votonin ditën e zgjedhjeve.

¹⁹ Kjo është në përputhje me Kodin e Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias të vitit 2002. Megjithatë, një numër i KZAZ-ve zbatuan procedurat për verifikimin e nënshkrimeve nënshkrimeve, përcaktuar nga Neni 71 i Kodit Zgjedhor, në mënyrë të paqendrueshme.

²⁰ PSD-ja gjithashtu nga ana e saj, kundërshtoi vendimin Nr.88 të KQZ-së në Kolegji Zgjedhor duke argumentuar se teksti përfundimtar i vendimit të publikuar në lidhje me aspektet thelbësore të ligjit ishte ndryshe nga ai që u vendos në mbledhjen publike të KQZ-së. PSD-ja theksoi publikisht se versioni origjinal që përjashton kryetarët aktual të të gjithë NJQV-ve nga mbledhja e nënshkrimeve, ndërsa versioni i rishikuar kërkonte që kjo të ishte vetëm për kryetarët aktual të komunave. Ky ankim u rrëzua për arsye procedurale pa komente mbi çështjen në themel.

duhet të mblidhnin nënshkrime. Në kontrast me këtë, KQZ-ja regjistroi kandidatin tjetër të PSD-së, i cili dorëzoi certifikatën e mandatit në KZAZ brenda afatit ligjor. Kolegji Zgjedhor e rrëzoi këtë vendim mbi ankimimin e PS-së, duke vendosur ndër të tjera se një numër nënshkrimesh u vërtetuan të ishin të falsifikuara.²¹

Kodi Zgjedhor përjashton mundësinë e ndryshimeve që bëhen listave të kandidatëve pas miratimit të tyre përfundimtar, por nuk rregullon dorëheqjen e kandidatëve për kryetar bashkie. Në 1 qershor, pas një procesi të zgjatur të ankesave dhe kërkesave ankimore, KQZ-ja refuzoi dorëheqjen e kandidatit për kryetar bashkie të PD-së në Kurbin, duke iu referuar mungesës së një rregullimi të tillë në ligj dhe argumentimit të pamjaftueshëm të paraqitur nga kandidati. Rrjedhimisht, KQZ-ja refuzoi kërkesat nga kandidatët për kryetar bashkie për t'u dorëhequr nga garat në Korçë, Kuçovë dhe Dropull; ndërkohë që u pranuan dorëheqjet e kandidatëve në Memaliaj, Sarandë dhe Këlcyrë.²²

Interpretimi i kufizuar dhe zbatimi i paqendrueshëm i rregullave mbi regjistrimin e kandidatëve pengoi të drejtën për të garuar të kandidatëve në të njëjtat kushte, në kundërshtim kjo me angazhimet e OSBE-së dhe standarteve të tjera ndërkombëtare.²³ Proçedurat e ankimit mbi regjistrimin dhe dorëheqjet e kandidatëve vijuan gjatë gjithë periudhës zyrtare të fushatës, duke dëmtuar rrezikuar mundësinë e barabartë për të zhvilluar fushatën zgjedhore.

Mjedisi i fushatës dhe financimi i fushatës

Atmosfera e fushatës ishte paqësor, përveç incidenteve të izoluar. Liritë themelore të shprehjes dhe të tubimit u respektuan. Fushata ishte aktive dhe e dukshme në zonat urbane dhe më modeste në zonat rurale. Ajo u dominua nga PS-ja, LSI-ja dhe PD-ja por edhe nga fushatat e PDIU-së. Një numër modest kandidatësh të pavarur gjithashtu ishin të dukshëm në disa pjesë të vendit. Fushatat u përqëndruan më shumë në zgjedhjet për kryetar bashkie, por vëmendja kombëtare u përqëndrua tek garat në Tiranë, Durrës dhe Shkodër.

Fushata u rrit pas çeljes zyrtare në fillim të majit dhe u intensifikua me afrimin e ditës së zgjedhjeve.²⁴ Ndërsa tubimet dhe vizitat derë më derë vijuan të mbaheshin, pati një tendencë të përhapur në të gjithë vendin drejt mbajtjes së forumeve më të vogla të fushatës, ku kandidatët dhe qytetarët mund të ndërvepronin drejtpërsëdrejti. U zhvilluan debate midis kandidatëve për kryetar bashkie, nga një numër bashkish përfshirë Beratin, Fierin, Gjirokastrën, Himarën dhe Shkodrën duke tërhequr vëmendje të madhe të medias dhe publikut. Media sociale u përdor gjerësisht për fushatë nga partitë dhe kandidatët.

Fushata u dominua nga kryetarët e partive kryesore të vendit dhe u përqëndrua gjerësisht në çështjet sociale dhe ekonomike të tilla si rritja ekonomike, zhvillimi infrastrukturor, shëndetësia, arsimit, punësimi i të rinjve dhe taksat, të cilat deri tani mbeten kompetencë e qeverisë qendrore. Çështjet e barazisë gjinore u trajtuan në një sërë platformash të fushatës dhe vëmendje e madhe iu kushtua zgjedhësve gra, përfshirë veçanërisht disa tubime të mbajtura specifikisht për to. Gjithashtu partitë u përpoqën të tërhiqnin zgjedhës nga rradhët e Romëve dhe Egjiptianëve.

²¹ Nënshkrimet e falsifikuara u gjendën në të tre rastet e dorëzuara nga KQZ-ja për hetim në MB dhe rrjedhimisht iu dërguan edhe prokurorive përkatëse.

²² Arsyet e dhëna nga KQZ-ja për pranimin e këtyre dorëheqjeve përfshinin dorëzimin e një deklaratë për dorëheqje e vërtetuar nga noteri dhe akuzat për të dhëna kriminale të deklaruara nga partia.

²³ Paragrafi 15 i Komentit të Përgjithshëm të UNCHR Nr.25 të vitit 1996, i Nëniti 25 të shteteve KNDCP përcakton që “Çdo kufizim mbi të drejtën për të konkuruar për zgjedhjet duhet të jetë e justifikuar mbi kritere objektive dhe të arsyeshme.” Shih gjithashtu paragrafin 24 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 i cili parashikon se çdo kufizim mbi të drejtat duhet të jetë “Në përputhje rigorozë me qëllimin e ligjit.”

²⁴ Kodi Zgjedhor përfshin një sërë dispozitash, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mbulimin e paanshëm në media, të cilat filluan në datën e hapjes së fushatës, me synimin për të krijuar një nivel konkurimi të njëjlojtë në garë.

Toni i fushatës është përmirësuar, përfshirë Tiranën ku ajo u drejtua në mënyrë qytetare nga të gjithë kandidatët për kryetar bashkie. Megjithatë, partitë më të mëdha vijuan të shkëmbejnë akuza personale dhe u përpoqën të diskretitojnë konkurruesit e tjerë. Në disa zona, pati akuza për presione dhe pengesa ndaj kandidatëve të pavarur dhe partive të vogla.²⁵ Gara për kryetar bashkie në Vorë ishte veçanërisht e ashpër dhe përfshiu akuza për kërcënime serioze.²⁶ Në disa raste, u arritën marrëveshje jozyrtare midis partive më të mëdha politike rreth ekspozimit të materialeve të fushatës, me qëllim uljen e mundësive të konfliktimit midis mbështetësve.²⁷

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori akuza të shumta për presion të ushtruar ndaj nënpunësve shtetëror, kryesisht ndaj mësuesve dhe punonjësve të shëndetësisë, përfshirë këtu kërkesa për të marrë pjesë në fushatat e ASHE-së dhe kërcënime për heqje nga puna nëse ata nuk votojnë për një kandidat të caktuar.²⁸ Këto akuza së bashku me shembujt e vëzhguara ditën e zgjedhjeve, ngritën shqetësime rreth mundësisë së zgjedhësve për të hedhur votën e tyre (pa frikën e ndëshkimit), siç e parashikon paragrafi 7.7 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.

Personalitetet kryesore nga partitë e mëdha qeverisëse shpërndanë certifikata për legalizimin e pasurisë në aktivitetet e fushatës,²⁹ dhe një numër kandidatësh të ASHE-së përdorën aktivitete dhe burime shtetërore,³⁰ duke zbehur kështu ndarjen midis shtetit dhe partisë dhe duke shkelur paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990.³¹

Gjithashtu pati akuza të blerjes së votës, si edhe individë për individë që u dorëzonin kartat e tyre të identitetit partive përpara ditës së zgjedhjeve. Personalitetet kryesore të partive parlamentare dhe joparlamentare e njohën këtë si tipar të zgjedhjeve në Shqipëri.

²⁵ Për shembull, në Tiranë një kandidat i pavarur i raportoi MVZ-së së OSBE/ODIHR-it që pati vështirësi për të gjetur pronarë mjedisesh private të cilët mund ta lejonin mbajtjen e takimeve të fushatës, pasi i frikësoheshin pasojave. Në një nga aktivitetet e fushatës së tij MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi, pjesëmarrës nga administrata shtetërore të cilët shprehën shqetësime për mundësinë e filmimit të tyre nga media. Në Kuçovë, kandidati për kryetar bashkie i Partisë së Frontit të Majtë u shpreh për “ABC News” se është kërcënuar nga anëtarët e degës vendore të LSI-së.

²⁶ PD-ja dhe PR-ja pretenduan se kandidati i APPD-së kryetari aktual i bashkisë u shenjestrue nga LSI-ja. Gjatë javës së parë të fushatës, një agro-biznes në pronësi të kandidatit u mbyll për disa ditë nga Ministria e Bujqësisë. PD-ja dhe PR-ja pretenduan se më vonë policia u përpoq të arrestonte kandidatin e tyre dhe se stafi i fushatës u kërcënuar.

²⁷ Për shembull, në Rrogozhinë një nga kandidatët për kryetar bashkie informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se një marrëveshje jozyrtare u arrit midis partive kryesore për të hequr flamujt e tyre, në tubimet ku marrin pjesë politikanët kryesorë. Në Has, kryetari i bashkisë informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se partitë ranë dakord të mos vendosnin banerat në mënyrë që të ulnin mundësinë për incidente që mund të ndodhnin ndërmjet mbështetësve. Në fund të fushatës, u arrit një marrëveshje midis PS-së dhe PD-së që tubimi mbyllës i fushatës së PS-së të zhvillohej në Durrës, dhe i PD-së të zhvillohej në Tiranë, sesa të zhvilloheshin të dyja në Tiranë.

²⁸ Për shembull në Delvinë, kryetari aktual i bashkisë informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it, se bashkëshortja e tij u kërcënuar me heqje nga pozicioni i saj në një klinikë shëndetësore. Në Krujë, një person informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se e shoqja kish marrë kërcënime të ndiqte tubimin e PD-së. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it gjithashtu ka marrë raporte të besueshme se nënpunësit shtetëror të cilët ishin të pranishëm në tubimet e PS-së/LSI-së në Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Kukës, Shkodër dhe Vlorë ishin të udhëzuar të merrnin pjesë.

²⁹ Për shembull, në 24 maj fotot e Ilir Metës, kryetar i parlamentit dhe kryetar i LSI-së, duke shpërndarë certifikatat e legalizimit në Vorë, u transmetuan në televizion. Regjistrime të Erion Veliajt kandidat për Kryetar Bashkie të Tiranës i Aleancës për Shqipërinë Europiane, duke dhënë certifikatat e legalizimit u transmetuan në 23 dhe 26 maj.

³⁰ Për shembull, në 1 qershor Z.Veliaj, u shfaq me kryeministrin Rama dhe Ministren e Arsimit Lindita Nikolla për fillimin e punimeve të ndërtimit të Parkut Olimpik në Tiranë. Në 2 qershor Viktor Tusha kandidat i LSI-së për kryetar bashkie në Lezhë, kontrollonte punimet e ndërtimit të një ure në Lezhë sëbashku me Ilir Metën, dhe në 8 qershor u shfaq me Z.Meta në inaugurimin e nje linje të re tragetesh nga Shëngjini në Brindizi.

³¹ Paragrafi 5.4 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 parashikon për “një ndarje të qartë midis Shtetit dhe partive politike”

Partitë politike mund të financojnë fushatën e tyre zgjedhore nëpërmjet fondeve shtetërore, donacioneve private apo huave. Ligji parashikon kufizimet mbi kontributet dhe shpenzimet. Kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë të përfitojnë fonde shtetërore, në kundërshtim me detyrimet e OSBE-së.³²

Vendimi për shpërndarjen paraprake të kontributeve shtetërore për fushatë, u mor nga KQZ-ja 13 ditë pas fillimit të fushatës zyrtare.³³ Të gjitha partive dhe kandidatëve të pavarur u kërkohet të deklarojnë shumën e financimit privat që ata marrin dhe shpenzimet e kryera gjatë fushatës, por shpenzimet dhe të ardhurat e fushatës duhet tu raportohen vetëm audituesve të caktuar nga KQZ-ja pas zgjedhjeve.³⁴ Rregullat për raportimin e financimit të fushatës nuk janë të plota dhe mund të përforcohen për të siguruar më tepër transparencë në përputhje me standartet ndërkombëtare.³⁵

Media

Pavarësisht numrit të madh të mjeteve të informacionit, lidhjet e medias me partitë kryesore politike, që vjen si rrjedhojë e interesave të biznesit të pronarëve të mediave, shkakton ndërhyrje të drejtpërdrejtë në çensurimin e autonomisë mediatike, dhe dhe kufizoi pluralizmin e këndvështrimeve.³⁶ Transmetuesi i shërbimit shtetëror, Radio dhe Televizioni Shqiptar (*RTSH*), konsiderohet gjërësisht një mbështetës i qeverisë duke kontribuar në mungesën e lajmeve të pavarura në televizione (TV). Më tej, ndikimi i partive politike në programin e përcaktuar nga media lejon hapësira të kufijzuara për çështje më pak të politizuara të rëndësisë publike. Megjithatë, nuk ka ndërhyrje në lirinë e përdorimit të internetit dhe lajmet në internet ndihmojnë në mënyrë të vazhdueshme në pluralizëm, për shkak të autonomisë së tyre editoriale dhe hapësirës për këndvështrime alternative.

Kushtetuta dhe legjislacioni për median ofron gjërësisht lirinë e shprehjes. Megjithëse, dënimet më burgim për shpifje, mbrojtja për zyrtarët shtetërorë, si dhe përfshirja e prokurorëve dhe policisë në rastet e shpifjes u shfuqizuan në vitin 2012, shpifja ende përbën vepër penale, në kundërshtim me standartet ndërkombëtare.³⁷ Kodi i Transmetimit kërkon që transmetuesit të sigurojnë mbulim të paanshëm të aktorëve politik me qëllim sigurimin e pluralizmit politik, edhe pse zbatimi është penguar nga mungesa e mekanizmave efiksasë mbikqyrës duke përfshirë dhe ato ndërmjet zgjedhjeve.

Pranohet gjërësisht se filmimet e fushatës në lajmet e televizioneve (TV) prodhohen në mënyrë mbizotëruese nga vetë partitë politike, si materiale të regjistruara paraprakisht ose si transmetim i

³² Paragrafi 7.5 Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 parashikon për “respektimin e të drejtës së shtetasve për të kërkuar detyra shtetërore dhe politike, në mënyrë të pavarur ose si përfaqësues të partive politike apo organizatave pa asnjë dallim.”

³³ Parlamenti akordoi shumën 65 milion ALL (rreth 465,000 EURO) për kontributet shtetërore të fushatave zgjedhore. 1 EURO është përafërsisht 140 ALL (Lek Shqiptare).

³⁴ KQZ-ja duhet të publikojë raportet e auditit jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të raporteve financiare; megjithatë ligji nuk e specifikon kur raportet duhet t’u dorëzohen audituesve.

³⁵ Në përputhje të nenit 7.4 të Konventës Kundër Korrupsionit të KB-së viti 2003 “Çdo parti shtetërore duhet të marrë masat e duhura administrative dhe legjislative... për të rritur transparencën e financimeve të kandidatëve për detyrat e zgjedhura shtetërore.”

³⁶ Paragrafi 36 (Dimensioni Njerëzor i Dokumentit të Budapestit të OSBE-së, të vitit 1994 thekson se “mediat e pavarura dhe pluraliste janë thelbësorë për një shoqëri të hapur dhe të lirë dhe sistemeve të përgjegjshme të qeverisë”.

³⁷ Shiko paragrafin 47 të UNCHR-së viti 2011, komenti i përgjithshëm Nr.34 i Nenit 19 i (KNDCP). Në 5 qershor, dy anëtarë të të PD-së në Parlament Z. Paloka dhe Z.Ristani, u dënuan nga Gjykata e Lartë për shpifje ndaj Kryeministrit dhe u detyruan të paguanin një gjobë prej 200,000 ALL. Neni 71 i Kushtetutës përcakton që mandati i deputetit është i pavlefshëm kur dënohet për vepër penale më vendim të prerë gjykatë. Për më tepër në 6 qershor një padi për vepër penale për shpifje u regjistrua kundër Besjana Selfo nga Kandidatja e LSI-së Zamira Rami. Znj. Selfo shkroi një koment rreth kandidates në rrjetin social dhe përpos amendamenteve të 2012-tës të Kodit Penal ajo u mor në pyetje nga Prokuroria Shtetërore në të njëjtën ditë.

drejtpërdrejt nga aktivitetet e fushatës. Edhe pse lejohet nga Kodi Zgjedhor, kjo i jep partive politike akses të drejtpërdrejt në lajme dhe mjegullon ndarjen strikte midis përmbajtjes editoriale dhe reklamave politike.³⁸ Për më tepër, disa redaktorë informuan MVZ-n e OSBE/ODIHR-it se ata janë të detyruar të përdorin filmimet bazuar në vendimin e KQZ-së së vitit 2013 i cili i kërkon mediave të pranojnë regjistrimet në përputhje me kërkesat teknike.

Kodi Zgjedhor përfshin dispozita të detajuara për mbulimin e paanshëm të lajmeve dhe ju ofron konkurruesve kohë transmetimi pa pagesë dhe të drejta për blerjen e kohës së transmetimit.³⁹ Nga 22 maji Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) ka paraqitur raporte të monitorimit sasior ditor në KQZ për 13 televizione (TV) dhe 2 stacione radiofonike.⁴⁰ Edhe pse dispozitat përfshijnë të gjithë transmetuesit, BMM-ja kishte mungesë stafi, pajisjelesh dhe metodologjie për të monitoruar në mënyrë efektive numrin e madh të transmetuesve, ose tonin e mbulimit mediatic.⁴¹ KQZ-ja votoi kundër disa propozimeve të BMM-së për gjoba kundër televizioneve për mbulimin më të madh mediatic të një prej konkurruesve kryesorë, çka është në kundërshtim me parashikimet ligjore.⁴² Në vend të kësaj, KQZ-ja vendosi t'i japë stacioneve televizive më tepër kohë për të balancuar mbulimet mediaticke. Në 15 qershor, raporti i BMM-së në KQZ arriti në përfundimin se, në përgjithësi transmetuesit e balancuan mbulimin e tyre dhe KQZ-ja vendosi gjoba vetëm dy transmetuesve vendor për shkeljen kryesisht të disa dispozitave të tjera ligjore. Gjithësesi rezultatet e monitorimit të bashkangjitura me raportin nuk shfaqën mbulim të paanshëm për konkuresit.

Monitorimi i OSBE/ODIHR-it tregoi se asnjë nga stacionet e TV-ve të monitoruara nuk ofroi barazi në mbulimin e lajmeve për dy konkuresit kryesorë ashtu siç ka për qëllim Kodi Zgjedhor.⁴³ Tre nga pesë stacione TV-sh të monitoruara, duke përfshirë dhe TVSH-në, kanë treguar anësi në favor të ASHE, ndërsa dy stacione TV-ve favorizuan APPD. TVSH-ja i kushtoi 63 përqind ASHE-së dhe 33 përqind APPD. News 24 dhe Top Channel mbuluan ASHE-në me 56 përqind dhe 55 përqind përkatësisht secila, ndërsa të dyja i kushtuan 41 përqind APPD-së. Te dyja ABC News dhe Klan Tv i kushtuan 46 përqind ASHE-së dhe 53 përqind dhe 50 përqind APPD-së përkatësisht, por më shumë se 40 përqind të mbulimit të ASHE-së ishte me tone negative.⁴⁴ Gazetat e monitoruara përgjithësisht ofruan mbulimin e fushatës më të ekuilibruar.

TVSH-ja përmbushi detyrimet e saj ligjore për të transmetuar kohë falas të paanshme për konkurruesit. Sasia e ulët kushtuar mbulimit të konkurruesve që nuk garonin në dy koalicionet kryesore (më pak se 6 përqind në të gjithë 11 partitë që garonin veçmas, ashtu si kandidatët e pavarur të stacioneve të TV-ve të monitoruara) mbetën të pafavorizuar dhe me informacion të kufizuar për alternativat politike. Pjesërisht kjo u korrigjua nëpërmjet debateve në programet televizive të cilat kontribuan në mënyrë pozitive për të zgjeruar informacionin tek zgjedhësit. Gazetat e monitoruara favorizuan ASHE-në në mbulimin e fushatës së tyre.

³⁸ Më tepër, gazetarët të cilët punojnë me transmetues të të gjithë vendit dhe rajoneve informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it mbi aksesin e ndaluar të ekipeve të filmimit në aktivitetet e fushatës.

³⁹ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, Kodi Zgjedhor parashikon se mbulimi i aktiviteteve “institucionale”, të cilat u përdorën për “qëllime zgjedhore” llogariten në favour të partisë respektive dhe përcakton cilat janë “qëllimet zgjedhore”, duke udhëhequr median që të bëjë dallimin e qartë midis të dyjave.

⁴⁰ Secili nga shtatë anëtarët e BMM-së, caktohet nga një anëtarë i KQZ-së nga lista e kandidatëve propozuar nga organizatat jofitimprurëse të medias.

⁴¹ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re interpretim jokonsistent të dispozitave ligjore, pajisje të pakta dhe mungesë aksesit në media të monitoruesve vendor të BMM-së.

⁴² Kodi Zgjedhor përcakton se në rastet kur barazia e mbulimit mediatic shkelet, transmetuesit gjobiten deri në shumën 3,000,000 ALL.

⁴³ Midis 17 majit dhe 20 qershor MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi mbulimet politike gjatë fashës kohore me shikueshmëri më të lartë të aktorëve politik në pesë kanale televizive (TVSH-ja shtetërore, ABC News, News 24, Top Channel dhe Klan TV private) dhe tri gazetat (Gazeta Shqiptare, Panorama dhe Shqip).

⁴⁴ Mbulimi i lajmeve nga të dy koalicionet në TVSH, News 24 dhe Top Channel u mbizotërua pozitivisht dhe me tone asnjëanëse.

Ankesat dhe Kërkesat Ankimore

Sipas Kodit Zgjedhor, vetëm subjektet zgjedhore kanë të drejtë të ankimojnë vendime të organeve të administratës zgjedhore. Përkufizimi për subjektin zgjedhor ka mungesë qartësie.⁴⁵ Në dy raste KQZ-ja ka rrëzuar ankimimet e regjistruara nga kandidatët për kryetar bashkie pasi ata nuk u konsideruan si subjekte zgjedhore. Zgjedhësit mund të apelojnë vetëm gabimet në Listat e Zgjedhësve dhe grupet e vëzhguesve vendorë mund të apelojnë vetëm vendimet që refuzojnë akreditimin e tyre.⁴⁶ KQZ-ja shqyrton të gjithë ankimet kundër vendimeve të KZAZ-ve dhe duhet të marrë vendim brenda dy ditëve.⁴⁷ Vendimet e KQZ-së apo mosmarrja e një vendimi mund të ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, vendimet e të cilit janë të formës së prerë. Rastet të cilat mund të përbëjnë vepra penale i raportohen prokurorëve por hetimet e tejzgjatura të tyre nuk sigurojnë respektimin e afateve kohore nga pikëpamja zgjedhore, përfshirë afatet në regjistrimin e zgjedhësve dhe verifikimin e nënshkrimeve.

Deri tani, KQZ-ja ka marrë 24 ankime kundër vendimeve të KZAZ-ve, shumica në lidhje me regjistrimin e kandidatëve. Në disa raste, KQZ-ja shmangu marrjen e vendimeve përfundimtare, ashtu siç e parashikon ligji dhe ia ktheu ato për shqyrtim KZAZ-ve. Një sërë vendimesh të KQZ-së nuk janë marrë në përputhje me qëllimin e ligjit duke bërë një interpretim të paqëndrueshëm dhe arbitrar të ligjit, që çoi në pasiguri ligjore. Në shumicën e rasteve të vëzhguara, KQZ-ja nuk mundi të marrë vendime përfundimtare mbi ankimet brenda afateve të kërkuara ligjore.

Kolegji Zgjedhor shqyrtoi 23 kërkesa ankimore në mënyrë të përshpejtuar me 5 gjyqtar në seanca të hapura. Megjithatë, vendimet nuk u publikuan në faqen e internetit të Gjykatës së Apelit të Tiranës në kohën e duhur.

Në një rast Kolegji Zgjedhor nuk e ushtroi juridiksionin e tij për të zgjidhur një çështje në themel si organi përfundimtar për ankimimin, por e ktheu atë tek KQZ për shqyrtim të mëtejshëm. Në rastin tjetër, lista e kandidatit të Partisë Kristian Demokrate (PKD-së) për këshillin bashkiak të Krujës nuk u regjistrua për shkak të mosveprimit të KZAZ-së.⁴⁸ PKD-ja e kundërshtoi vendimin e KQZ-së për miratimin e fletës së votimit pa përfshirjen e tyre. Kolegji Zgjedhor rrëzoi kërkesën ankimore dhe deklaroi që mungesa e veprimit nga ana e KZAZ-së për të ushtruar detyrat e saj nuk ishte e mjaftueshme për të shpallur të pavlefshëm vendimin e KQZ-së.

Nuk u shfrytëzuan gjërisht mekanizmat e ankimit, edhe pse shumë parti politike ngritën akuza të shkeljes së fushatës. Disa nga ankimet e dorëzuara në KZAZ, kanë lidhje kryesisht me vendosjen e materialeve të fushatës. Baza ligjore mbi juridiksionin dhe procesin e shqyrtimit të ankesave lidhur me zhvillimin e fushatës, është e paqartë. Për shkak të mungesës së qartësisë, KZAZ-ja numër 11 refuzoi të shqyrtojë një rast të paraqitur nga PD, në lidhje me presionin e ushtruar ndaj nëpunësve shtetërorë për të marrë pjesë në tubim.

Bashkëbiseduesit e ndryshëm të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën mungesën e besimit në administrimin zgjedhor dhe në shqyrtimin e paanshëm të ankimeve nga gjykatat. Në përgjithësi, mënyra me të cilën komisionet zgjedhore dhe Kolegji Zgjedhor shqyrtojnë ankimet zgjedhore nuk

⁴⁵ Neni 2 pikë 20 i Kodit Zgjedhor përkufizon subjektet zgjedhore si parti politike, koalicionet, kandidatët të pavarur dhe kandidatët për kryetar bashkie. Megjithatë, neni 63 nuk e cilëson kandidatin për kryetar bashkie si subjekt zgjedhor.

⁴⁶ Sipas reformës gjyqësore të vitit 2012, legjislacioni nuk është i qartë se cila nga gjykatat është përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve të listave zgjedhore.

⁴⁷ Neni 143/3 i Kodit Zgjedhor detyron KQZ-në të marrë vendim brenda 2 ditëve nga dorëzimi i ankimit, ndërsa neni 133 përcakton afatin 48 orësh nga vendimi i KQZ- së për të pranuar një ankim.

⁴⁸ PKD-ja dorëzoi dokumentet për regjistrim të listës së kandidatëve në KZAZ në 1 maj; megjithatë KZAZ-ja regjistroi listat në 26 maj pasi KQZ-ja kishte miratuar fletën e votimit.

ofruan zgjidhje efektive apo në kohë për palët e interesuara, në kundërshtim kjo me paragrafin 5.10 të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, 1990 dhe të standarteve të tjera ndërkombëtare.⁴⁹

Pjesëmarrja e minoriteteve kombëtare

Minoritetet, në përgjithësi nuk hasën diskriminim gjatë procesit zgjedhor. Ndonëse nuk ka një rregullim ligjor, minoriteteve kombëtare u sigurohen të drejta të plota sipas Kushtetutës. Gjithsesi, në disa raste, pjesëmarrja efektive e zgjedhësve u kufizua nga vështirësitë e gjuhës, varfëria, dhe nga mungesa e dokumenteve të regjistrimit civil dhe në disa raste vështirësitë e gjuhës.⁵⁰ Shumë nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it raportuan se komunitetet Rome dhe Egjiptiane mbeten të cënuar nga praktikatat e blerjes së votës. Ndërsa disa nga kandidatët e minoriteteve u përfshinë në listat e partive kryesore, ata zakonisht nuk u vendosën në pozicione fituese. Përfshirja e tyre në lista u përcaktua nga disa si një taktikë zgjedhore.

Ndërsa fletët e votimit u përgatitën vetëm në Shqip, KQZ-ja shpërndau materiale për informimin e zgjedhësve në gjuhët minoritare, megjithëse kjo u bë vetëm në një fazë të vonshme. Një program për edukimin e zgjedhësve për gratë Rome dhe Egjiptiane u mbështet nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Ndërgjegjësimi i komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në lidhje me vlerën e votës është në rritje, ashtu si edhe përfshirja e tyre në fushatë.

Vëzhguesit Vendorë dhe Ndërkombëtarë

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë të të gjitha niveleve të administrimit zgjedhor. Procesi i akreditimit për vëzhguesit ishte gjithëpërfshirës dhe zgjedhjet u vëzhguan nga një numër konkurruesish zgjedhor, si edhe 4252 vëzhgues vendorë dhe 933 vëzhgues ndërkombëtarë. E drejta për të caktuar vëzhguesit brenda një koalicioni qëndron vetëm brenda koalicionit dhe jo brenda partive të tyre.

Dita e Zgjedhjeve

Dita e Zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë paqësore në gjithë vendin. Në mesnatë KQZ-ja njoftoi se pjesëmarrja paraprake e votuesve, bazuar në të dhënat e marra nga 55 përqind e qendrave të votimit, ishte 47 përqind. Ndërsa vëzhguesit partiak ishin të pranishëm, kryesisht në të gjitha fazat e vëzhgimit, vëzhguesit vendorë u vunë re në më pak se 20 përqind të qendrave të votimit gjatë ditës së zgjedhjeve dhe vëzhguan më pak se 50 përqind të qendrave të numërimit.

Në shumicën e rasteve të vëzhguara, qëndrat e votimit u hapën me vonesë. Kjo kontribuoi në një vlerësim përgjithësisht negativ të procedurave të hapjes në 25 përqind të vëzhgimeve. Nga vëzhgimet u konstatua se hapja vonë e qendrave të votimit ndodhi kryesisht për shkak të mungesës së anëtarëve të Komisioneve të Qendrave të Votimit, mungesës së njohurive për procedurat ose mungesës së materialeve zgjedhore. Qendra speciale e votimit në burgun e Rrogozhinës nuk u hap aspak.

Votimi u vëzhgua si i rregullt gjatë ditës dhe u vlerësua pozitivisht në 93 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. U siguroi transparenca e procesit dhe vëzhguesit mund të ndiqnin procedurat pa

⁴⁹ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, 1990 parashikon: "... çdokush duhet të ketë mjete efektive të dëmshpërblimit kundër vendimeve administrative, duke garantuar kështu respektimin e të drejtave themelore dhe sigurimin e integritetit ligjor." Neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut "Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme ...për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore..."

⁵⁰ Disa nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it konsideruan gjobën prej 1,200 ALL për lëshimin e ndaluar të dokumenteve të identitetit dhe të tjerët raportuan shembuj të partive politike duke paguar dokumente identifikimi për zgjedhësit Romë, në përpjekje për të ndikuar te vota e tyre.

kufizime në pothuajse të gjitha qendrat e votimit. Vëzhguesit e Misioneve Ndërkombëtare të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) raportuan që votimi u ndërpre për disa orë në Devoll, Roskovec and Tepelenë, për shkak të parregullsive të vërejtura në fletët e votimit.⁵¹ Më vonë, KQZ-ja morri një vendim për rinisjen e procesit të votimit në zonat në fjalë, pa ndryshuar fletët e votimit.

Ndërkohë që vlerësimi i përgjithshëm është pozitiv, janë vënë re disa gabime proceduriale. Timbrosja dhe procedura e verifikimit të timbrosjes, masat kyçe mbrojtëse ndaj votimit të shumfishtë, nuk janë respektuar respektivisht në 6 përqind dhe 13 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara. Raste të votimit në grup janë vërejtur në 17 përqind të qendrave të votimit, të cilat rezultojnë të kenë një ndikim të shpërpjestuar në zgjedhëset gra. Votimi me përfaqësim u vërejt në 5 përqind të qendrave të votimit të vizituara, ndërkohë që një sërë nënshkrimesh identike në dukje u vërejtën në 3 përqind të qendrave të votimit të vëzhguara, çka mund të jetë tregues i votimit të shumfishtë me përfaqësim. Fshehtësia e votës mund të ketë qenë e kompromentuar në 4 përqind të qendrave të votimit të vizituara. Vëzhguesit e Misioneve Ndërkombëtare të Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) raportuan që në 57 përqind të vëzhgimeve, ambientet e votimit nuk ishin të aksesueshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Materialet e fushatës në 150 metra afërsi me qendrat e votimit u vunë re në 22 përqind të vëzhgimeve, me tension ose trazira në qendrat e vendimit ose afërsitë e tyre u raportuan në 3 përqind të vëzhgimeve. Në disa zona, grupet e aktivitetëve të partive që qëndronin pranë qendrave të votimit u vërejtën të ishin potencialisht kërcënues për zgjedhësit. Kjo ishte shume problematike në Vorë. Në Berat dhe Durrës, dy raste të dukshme të blerjes së votës u vërejtën veçanërisht duke targetuar komunitetet e Romëve dhe Egjyptianëve.

Mbyllja e qendrave të votimit dhe transferimi i materialeve në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) u vlerësua përgjithësisht pozitiv, megjithëse 20 % e Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) nuk mundën të dërgonin materialet e tyre në VNV-ë brenda afatit ligjor prej tre orësh. Numërimi nuk nisi menjëherë mbas marrjes së materialeve për shkak të pushimeve të deklaruara mbi në më shumë se gjysmat e VNV-ve të vëzhguara. Vëzhguesit e MNVZ raportuan që disa ekipe numërimi ishin ende duke u emëruar dhe trajnuar. Fazat e hershme të numërimit u vlerësuan pozitivisht, me disa gabime proceduriale të vëna re. Megjithatë në një të tretën e VNV-ve të vizituara, vëzhguesit nuk kishin një ide të qartë të procedurave të numërimit. Procesi i numërimit mbetet në vazhdim në të gjitha VNV-të e vëzhguara.

*Versioni anglisht është i vetmi dokument zyrtar.
Ky raport është i disponueshëm edhe në gjuhën shqipe.*

⁵¹ Në Devoll, emri i APPD ishte shkruar gabim në fletët e votimit për Këshillin Bashkiak, ndërsa në Roskovec dy kandidatë për kryetar bashkie ishin listuar me të njëjtin emër koalicioni ASHE. Së fundi në Tepelene numëri i kandidatëve në fletën për kryetar bashkie ishte i pasaktë.

INFOMACION MBI MISIONIN DHE FALENDERIME

Tirana, 22 qershor 2015 – MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it nisi punën në Tiranë në 15 Maj. Ai përfshin 16 ekspertë që punojnë në kryeqytetin e Shqipërisë dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në 10 vende në të gjithë Shqipërinë.

Në ditën e zgjedhjeve, u punësuan rreth 200 vëzhgues, duke përfshirë 24 anëtarë të delegacionit të cilët përfaqësojnë 15 shtete nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës. Gjithsej ishin 32 vëzhgues nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Hapja e votimit u vëzhgua në 65 QV, ndërsa procesi i votimit u vëzhgua nga 5,301 QV-të në të gjithë vendin. Numërimi i fletëve të votimit dhe përmbledhja e rezultateve nga 90 VNV-të, 32 prej tyre u vëzhguan.

Vëzhguesit dëshirojnë të falenderojnë autoritetet për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, KQZ-në për bashkëpunimin e saj dhe për sigurimin e dokumenteve akredituese, Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe organet e tjera dhe autoritetet vendore për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre gjatë kohëzgjatjes të vëzhgimit. Vëzhguesit do të dëshironin të shprehnin vlerësimin e tyre për Prezencën e OSBE-së në Shqipëri,⁵² Komisionerin e Lartë për Minoritetet Kombëtare të OSBE-së, organizatave dhe ambasadave të tjera ndërkombëtare, si edhe partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, dhe përfaqësuesit e medias për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre.

Për informacione të mëtejshme ju lutemi kontaktoni:

- Ambasadoren Audrey Glover, Shefe të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it në Tiranë (+355 4 450 0770)
- Thomas Rymer, Zëdhënës i OSBE/ODIHR-it (+48 609 522 266), ose Alexey Gromov, Këshilltar Zgjedhor i OSBE/ODIHR-it në Varshavë (+48 22 5200 667);
- Stewart Dickson, Shefi i Delegacionit të Kongresit (+44 782 466 7595) apo Znj.Renate Zikmund, Shefe e Departamentit të Kongresit të Vëzhgimit për Zgjedhjet Vendore dhe Rajonale (+33 659 786 455)

Adresa e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it:

Adresa: Kati i tretë, Ndërtesa “Trema”, Hyrja A, Rruga: “Bardhok Biba”
Telefon: +355 4 450 0770; Fax: +355 4 454 0420; e-mail: office@odihr.al;
Faqja e internetit: <http://www.osce.org/odihr/elections/albania/153826>.

⁵² MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri veprojnë të ndara bazuar të mandateve të tyre të veçanta.